

VENDIM
Nr.113, datë 24.2.2010

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR PËR KALIMIN E FONDIT NGA “PROJEKTI KRUJA II” NË PROJEKTIN “PROGRAMI PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË LIQENIT TË OHRIT- SHKARKIMI I UJËRAVE TË ZEZA NË POGRADEC II”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar për kalimin e fondit nga “Projekti Kruja II” në projektin “Programi për mbrojtjen e mjedisit të liqenit të Ohrit-Shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec II”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIMIN FINANCIAR (FURNIZIMI ME UJË DHE SHKARKIMI I UJËRAVË TË ZEZA NË KRUJË II-VITET E PREMTIMIT 2001 DHE 2008)

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë,

në frymën e marrëdhënieve miqësore ekzistuese ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë;

duke u nisur nga dëshira për t’i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet bashkëpunimit financiar si partnerë;

të ndërgjegjshëm se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj Marrëveshjeje;

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë;

duke iu referuar protokolleve të bisedimeve ndërqeveritare të datës 5 dhjetor 2001 dhe të datës 7 tetor 2008 dhe notës verbale nr.09/09 të ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë të datës 16 janar 2009, si dhe marrëveshjes së datës 22 shtator 2003 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar (Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001),

u morën vesh si vijon:

Neni 1

1. Shumat e financimit, të parashikuara në marrëveshjen e datës 22 shtator 2003 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001) për projektin “Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II”, do të përdoren me një shumë prej 800 000 eurosh (tetëqind mijë eurosh) për projektin “Programi i mbrojtjes së mjedisit të liqenit të Ohrit-shkarkimi i ujërave të zeza në Pogradec II”, kur nga shqyrtimi përkatës u konstatua se projekti

në fjalë vlen për t'u mbështetur.

2. Përveç kësaj, janë të vlefshme dispozitat e marrëveshjes së datës 22 shtator 2003 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Republikës së Shqipërisë për bashkëpunimin financiar (Furnizimi me ujë dhe shkarkimi i ujërave të zeza në Krujë II-viti 2001).

Neni 2

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen e saj në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

Bërë në Tiranë, më datë 28.12.2009, në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe dhe gjermane, duke pasur secili tekst fuqi të barabartë.